



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 778 .Prot.

Rrogozhinë, më 19.02.2025

## NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Hënë datë 24.02.2025 ora 12:00<sup>oo</sup>**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.01.2025.
- 3- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2024 si dhe për aktivitetet e parashikuara për vitin 2025.
- 7- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
- 8- Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë.
- 9- Të ndryshme.
  - *Shqyrtim i kërkesës së znj. L. Rukaj dhe z. A. Bajraktaraj për hapje rruge në lagjen Elmadh, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevindh.*
  - *Shqyrtim i shkresës së Komisarariatit të Policisë Kavajë për gjetjen e zgjidhjes së një konflikti mes banorëve mbi zënien e rrugës së kalimit.*

**Mbledhjet e Komisioneve të KB**, si më poshtë :

(vijon)

---

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 21.02.2025 ora 10 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 21.02.2025 ora 10 : 30<sup>oo</sup>, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave, me këtë përbërje : Lulzim Hasa - Kryetar, Isa Halili - Zv.Kryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 21.02.2025 ora 11 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit, me këtë përbërje : Sokol Gosa - Kryetar, Erind Tosku - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Fatmira Thartori - Anëtare, Besnike Coraj - Anëtare.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 21.02.2025 ora 11 : 30<sup>oo</sup>, Komisioni Juridike, Rend, Konflike, me këtë përbërje : Mitat Daja - Kryetar, Indrit Dedej - Zv. Kryetar, Lulzim Hasa - Anëtar, Renato Kalemi - Anëtar, Merilin Saraçi.

**Shënim :** Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI